



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë: 28 prill 2026

**THIRRJE PUBLIKE PËR NJË ANËTARË (EKSPERT) TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR
PROJEKTE TË OSHC-ve NË AVANCIMIN E ZHVILLIMIT SOCIO-EKONOMIK
RAJONAL TË BALANSUAR PËR VITIN 2026.**

1. Hyrje

Ministria e zhvillimit Rajonal ka hapur thirrjen publike për projekt propozimet e organizatave të Shoqërisë civile që kanë për qëllim avancimin e zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar. Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) u bënë thirrje të gjitha anëtarëve nga organizatat e shoqërisë civile të regjistruara në Republikën e Kosovës si dhe ekspertëve shtetas në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e zhvillimit të aktiviteteve që kanë të bëjnë me zhvillimin socio – ekonomik rajonal të balancuar, që të aplikojnë për pjesëmarrje në komisionin e vlerësimit të projekt propozimeve të OSHC-ve që aplikojnë për këtë thirrje për propozime.

2. Thirrje për një anëtarë

Në kuadër të thirrjes për projekt-propozime, sipas Nenit 8 (3.2) të Rregullores MF – nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, MZHR hap këtë thirrje publike për zgjedhjen e një përfaqësuesve nga grupi i ekspertëve të jashtëm, njëri nga të cilët duhet të jetë përfaqësues i OJQ-ve.

3. Detyrat e Komisionit Vlerësues

Detyrat e Komisionit Vlerësues janë të përcaktuara me rregullore. Komisioni Vlerësues ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- të vlerësojë aplikacionet nga aspekti procedural sipas rregullores;
- të vendos nëse aplikantët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të parapara me rregullore për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike;
- të shqyrtojë dhe vlerësojë aplikacionet/propozimet e aplikantëve të kualifikuar për mbështetje financiare nga aspekti përmbajtësor;

- të sigurojë që projektet/programet e përzgjedhura për mbështetje financiare i plotësojnë të gjitha kriteret e thirrjes publike, dhe kontribuojnë arritjes së prioriteteve dhe objektivat e thirrjes;
- të kërkoj dokumentacion shtesë të nevojshëm nga aplikuesit pas publikimit të listës paraprake të përfituesve dhe para nënshkrimit të kontratës;
- të përzgjedh përfituesit e mbështetjes financiare sipas thirrjes publike.

Pjesëmarrja në Komisionin Vlerësues bëhet me pagesë, në shumën 266.20 euro.

4. Kualifikimet

Për të qenë anëtarë të Komisionit Vlerësues, aplikantët duhet të përmbushin këto kualifikime:

- Të kenë përfunduar me sukses studimet universitare në njërin nga fushat përkatëse: shkenca shoqërore, juridik, ekonomi ose biznes;
- Të kenë përvojë profesionale në hartimin, menaxhimin, zbatimin apo monitorimin e projekteve të organizatave joqeveritare (OJQ);
- Të kenë përvojë në proceset e vlerësimit të projekteve, programeve apo aplikacioneve, përfshirë edhe përvojën relevante në procedurat e prokurimit publik;
- Të kenë fleksibilitet kohor dhe gatishmëri për të marrë pjesë në mbledhjet dhe punën e Komisionit Vlerësues, sipas nevojave të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal gjatë muajve prill dhe maj 2026;

Rregulla të përgjithshme për përmbushjen e kualifikimeve: Nuk mund të emërohet anëtar i Komisionit Vlerësues asnjë person i emëruar politikisht, si dhe person që gjatë katër (4) viteve të fundit ka qenë kandidat në listë zgjedhore ose përfaqësues i ndonjë subjekti politik në procese zgjedhore. Secili nga anëtarët e Komisionit Vlerësues nënshkruan deklaratën mbi paanshmërinë dhe konfidencialitetin në vendimmarrje. Anëtarët e emëruar të Komisionit Vlerësues duhet paraprakisht të sigurohen që pjesëmarrja e tyre në këto komision është në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit, duke nënshkruar një deklaratë me të cilën deklarojnë se nuk ekziston konflikt interesi. Në rast të ekzistimit të konfliktit të interesit, anëtarët duhet të kërkojnë nga udhëheqësi zëvendësimin e tyre.

5. Dorëzimi i aplikacioneve

Ju lutem të dorëzoni CV-në tuaj ose një përmbledhje të përvojës/profilin tuaj profesional, dëshmitë për kualifikimet profesionale si dhe referencat për përvojën e punës jo më vonë se 05.05.2026 deri në ora 16:00 në e-mailin Shkrimorja.MZHR@rks-gov.net

MZHR mund të kërkojë dokumentacione shtesë prej aplikantëve nëse e vlerëson të nevojshme apo nëse ato nuk janë të kompletuara.